



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:117766

Datë: 15.12.2023

Numri i dokumentit: 05069689

P.nr. 518/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi - Imami, në çështjen penale kundër të pandehurit A.K. nga P., rr.”.....” nr..., i akuzuar për shkak të veprës penale *kanosje* nga neni 181 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr. 1081/19, të datës 30.05.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësorë, me datë 05.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha, të pandehurit A.K, palës së dëmtuar L.K, në të njëjtën ditë bie dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 15.12.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A. (B.) K, i lindur me datë ..., në P. me vendbanim në rr.”.....” nr..., nga babai B. dhe nëna F., e vajzërisë Zh., i identifikuar në bazë të numrit personal..., i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, pensioner, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e

Me datën 29.04.2019, rreth orës 08:30, në P, me qëllim të frikësimit , me fjalë e kanos tjetrin se do të i shkaktojë ndonjë të keqe dhe atë të dëmtuarën L.K, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri i cili njëkohësisht është edhe vjehri i të dëmtuarës , pasi që e dëmtuara një ditë më herët kishte dal së bashku me fëmijët te Sh. dhe pasi që kanë probleme në vazhdimësi mes vete, i pandehuri i është drejtuar me fjalët “ nuk dua me të pa më këtu në shtëpi se të mbys “, me çka tek e dëmtuara shkakton frikë dhe ankth , dhe e cila më pas e raporton rastin në polici.

- me çka ka kryer veprën penale “ kanosje” nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 7, 38, 39,40,43, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 181 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPRK-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind euro) €, të cilin dënim i pandehuri nuk do obligohet të paguajë nëse brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, nuk do të kryej veprë tjetër penale.

I pandehuri lirohet nga detyrimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 30.05.2019, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1081/19, ndaj të pandehurit A.K, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 05.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit L. H, të pandehurit A.K. dhe palës së dëmtuar L.K.

Gjykata konform dispozitave të nenit 319 par. 2 të KPPK-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës nuk do të angazhojë ngase nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës PP/II.nr.1081/19 të datës 30.05.2019 nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi që është i bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia që të deklarohet në lidhje me pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë e pranimin të fajësisë dhe pasojat e mospranimin.

I pandehuri A.K. deklarojë që e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet i penduar dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Prokurorja e shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, deklarojë që pranimi i fajësisë i plotëson kushtet ligjore dhe ka mbështetje në prova materiale në shkresa të lëndës, i propozojë gjykatës që të e aprovojë pranimin e fajësisë dhe të e marr si rrethanë lehtësuese.

Pala e dëmtuar L.K. deklarojë që e përkrah deklarimin e prokurores së shtetit nuk ka kërkesë për kompensim material.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 322 par. 1 të KPPRK-së, lidhur me nenin 242 par. 2 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza, edhe atë: raporti fillestar i incidentit i datës 29.04.2019, nr. rasti..., raporti i policit R. M, i datës 29.04.2019, deklarata e të dëmtuarës L.K, dhënë në Stacionin Policor në P, me datë 29.04.2019, intervista e të pandehurit A.K, dhënë në Stacionin Policor në P, me datë 29.04.2019, nr. rasti..., si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj gjykata mori aktvendim me të cilin pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit A.K. për veprën penale kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare deklarojë që pasi që i pandehuri bëri pranimin e fajësisë e njëjta propozojë gjykatës që të njëjtin të e shpallë fajtor, të e dënoj sipas ligjit , ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë dhe mosha e shtyrë.

E dëmtuara në fjalën e saj përfundimtare deklarojë që e mbështet fjalën e prokurorit të shtetit, duke kërkuar që të shpallet fajtor i pandehuri.

I pandehuri A.K. në fjalën e tij përfundimtare deklarojë që kërkon nga gjykata që të merr parasysh pranimin e fajësisë dhe të i shqipton një dënim sa më të lehtë.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A.K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale kanosje nga neni 181 par. 1 të KPPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të pandehurit ashtu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë së të pandehurit, i njëjti është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka konsideruar: pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, moshën e shtyrë të të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe ka të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 452 par. 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), pasi i njëjti është përfitues i pensionit në Kosovë në vlerë prej 100 (njëqind) euro me të cilën e mban familjen dhe veten, prandaj gjykata vlerëson se me ngarkimin e shpenzimeve të procedurës, të pandehurit dhe familjes së tij do të i rrezikohet gjendja materiale.

Gjykata nuk e udhëzoi palën e dëmtuar në kontest civil, pasi që pala e dëmtuar personalisht deklarojë që nuk ka kërkesë pasurore juridike nga ana e të pandehurit.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata e përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.518/19, datë 15.12.2023

Bashkëpunëtore Profesionale
Kaltrina Rexhepi - Imami

GJYQTARI
Veton Ademaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.